



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:200250

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05279257

P.2022:236421

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, në çështjen penale ndaj të Sh.K, për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri A.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri L.T për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri E.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i pandehuri E.K për veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 1313/22 të datës 03.11.2022, më datë **02.02.2024** merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimet 41/23 e datës 01.11.2023 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimet e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurve – dëmtuarve Sh.K, A.K, L.T, E.K, E.K.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 1313/22 të datës 03.11.2022 ndaj të pandehurit Sh.K, për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri A.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri L.T për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri E.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i pandehuri E.K për veprën penale Kanosja nga neni 181

paragrafi 2 të KPRK-së, pasi që lënda për pikat II, III, IV, V, VI, të aktakuzës PP/II.nr. 1313/22 të datës 03.11.2022 është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimit.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1313/22 të datës 03.11.2022, ndaj të pandehurit Sh.K, për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri A.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri L.T për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i pandehuri E.K për veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i pandehuri E.K për veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjti t'i shpall fajtor dhe të e dënoj sipas ligjit.

Për të pandehurin Sh.K në seancën e datës 31.10.2023 është veçuar procedura penale për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së – pikës I të aktakuzës PP/II.nr. 1313/22 të datës 03.11.2022

Gjykata me interesimin dhe pëlqimin e palëve e referoi lenden në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimit 41/23 e datës 01.11.2023

Lidhur me shpenzimet procedurale është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK

P.2022:236421 të datës 02.02.2024

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.